



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2021

V E N D I M

Nr. 203, datë 15/10/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.88, datë 12.05.2021, e z. S.L., ku pretendohet diskriminim për shkak të bindjes politike², nga ana e Bashkisë Vau i Dejës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, ankuesi ka punuar prej 6 vitesh në pozicionin e edukatorit pranë Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Ndre Mjeda”, Vau i Dejës, Shkodër. S.L. pretendon se gjatë gjithë periudhës që ka punuar në këtë pozicion pune, ka patur vlerësime pozitive për punën e kryer dhe ndaj tij nuk është dhënë ndonjë masë disiplinore.

Në vijim, ankuesi sqaron se i është dërguar shkresa nr. 7298/1, datë 21.12.2020, e Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, nëpërmjet së cilës ai njoftohet për zgjidhjen e kontratës individuale të punës, brenda një afati 2 mujor, duke filluar nga momenti i marrjes dijeni mbi shkresën e sipërcituar⁴.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD;

² Referuar Kartës së Anëtarësimit me nr. personal I5060210SS, datë 10.11.2012, lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë;

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD;

⁴ Marrja dijeni nga ana e S.L. pretendohet se ka qenë në datën 15.01.2021.

S.L. pretendon se nuk ka asnjë motivacion tjetër për zgjidhjen e kontratës së tij të punës, përveçse atij politik, duke arsyetuar se ai është anëtar dhe aktivist i subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë, dhe si i tillë diskriminohet për shkak të bindjeve të tij nga Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, i cili është përfaqësues i subjektit politik Partia Socialiste. Ndër të tjera, ankuesi pretendon se i është bërë presion në mënyrë të vazhdueshme për të votuar për subjektin politik Partia Socialiste dhe për një kandidat të kësaj force politike, por ai nuk ka pranuar. Ankuesi pretendon gjithashtu se në vendin e tij është emëruar një punonjëse, që nuk përmbush kriterin e vjetërsisë në punë dhe nuk ka kualifikimet e S.L.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr.88, datë 12.05.2021, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7⁵, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Durrës, me shkresën nr. 753/1, datë 21.05.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
 - 1.** Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
 - 2.** Kopje e librezës së punës, kontratës individuale të punës dhe aktit të emërimit në detyrë për z. S.L.;
 - 3.** Informacion mbi faktin nëse ndaj S.L. janë marrë masa disiplinore gjatë periudhës që ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Vau i Dejës. Nëse po, të dërgohen praktikat përkatëse për dhënie masash disiplinore;
 - 4.** Kopje të vlerësimeve në punë për z. S.L., nga viti 2015 – 2020;
 - 5.** Kopje e praktikës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, ku të përfshihet akti i njoftimit, shkresa që njofton për takim, procesverbali i takimit me ankuesin, akti nëpërmjet së cilit lirohet nga detyra dhe dokumentacion provues mbi motivacionin e lirit nga detyra.

⁵ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

6. Informacion i hollësishëm mbi punonjësit e liruar nga detyra nga Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, përgjatë vitit 2020, pranë Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Ndre Mjeda”, Vau i Dejës Shkodër dhe cilat janë motivacionet e largimit të tyre nga puna;
 7. Informacion nëse çështja e marrëdhënieve të punës me ankuesin është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor. Nëse po, lutemi të përcillet vendimi gjyqësor i gjykatës së shkallës së parë, ose ai i formës së prerë;
 8. Informacion mbi numrin e edukatorëve pranë Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Ndre Mjeda”, Vau i Dejës Shkodër, duke evidentuar datat e emërimit në detyrë për secilin prej tyre;
 9. Informacion mbi kriteret që duhet të përmbushë edukatori pranë Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Ndre Mjeda”, Vau i Dejës Shkodër, si dhe të dërgohet akti ku përcaktohen këto kriterë. Të dërgohen gjithashtu kopje të dosjeve personale të z. S.L. dhe punonjësit që e ka zëvendësuar.
- Në përgjigje të shkresës nr. 753/1, datë 21.05.2021, së KMD-së, Bashkia Vau i Dejës dërgoi shkresën nr. 3184/1 prot., datë 31.05.2021, nëpërmjet së cilës sqaron se ankuesi ka filluar marrëdhëniet e punës si edukator në Konviktin e Shkollës së Mesme Kombëtare “Ndre Mjeda”, Bushat, Shkodër, nëpërmjet Urdhërit nr. 01, datë 01.01.2015, të ish-Kryetarit të Komunës Bushat, detyrë, të cilën e ka kryer deri në datën 01.03.2021.

Bashkia Vau i Dejës sqaron se në kuadër të ristrukturimit të institucionit, i cili ka filluar në datën 15.12.2020 dhe ka përfunduar në datën 31.12.2020, S.L. është njoftuar me shkresën nr. 7298, datë 11.12.2020, mbi faktin se Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës do të fillojë procedurën e zgjidhjes së kontratës individuale të punës për pozicionin që ai mbante, si dhe sistemimin e tij në një pozicion tjetër pune brenda institucionit. Ankuesi edhe pse ka marrë dijeni për njoftimin e punëdhënësit për takim, e ka injoruar plotësisht atë veprim duke rënë në kundërshtim me nenin 23, të Kodit të Punës, si dhe me nenin 8, të Kontratës Individuale të Punës. Qëllimi i këtij takimi ishte që palët të kishin mundësi të parashtronin dhe diskutonin me njëra tjetrën zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Duke qënë se punëmarrësi nuk iu përgjigj thirrjes për takim me punëdhënësin, Bashkia Vau i Dejës ka hartuar njoftimin për zgjidhjen e kontratës individuale të punës, përkatësisht me shkresën nr. 7298/1, datë 21.12.2020, duke vendosur një afat 2 (dy) mujor, i cili fillonte nga momenti i marrjes dijeni mbi shkresën. Gjatë kësaj periudhe, punëmarrësit i janë dhënë 20 orë leje të pagueshme në javë, me qëllim për t'i dhënë mundësi aplikimi në një vend tjetër punë tjetër të lirë brenda institucionit ose jashtë tij. Gjatë kësaj periudhe kohore, S.L. i janë dhënë 20 orë leje të pagueshme në javë, me qëllim dhënien e mundësisë ankuesit për aplikim në një vend tjetër pune brenda institucionit apo në institucione të tjera.

Pas përfundimit të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës individuale të punës, Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës ka nxjerrë Urdhërin nr. 78, datë 26.02.2021, nëpërmjet së cilit ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me punëmarrësin në datën 01.03.2021. Punëmarrësi nuk ka bërë ankim kundër vendimit për zgjidhjen e kontratës individuale të punës pranë Bashkisë Vau i Dejës dhe as në gjykatë. S.L. nuk ka masë disiplinore në fuqi dhe njësia përkatëse organizative pranë konviktit, ku ai punonte nuk ka bërë vlerësime pune për punonjësit.

Bashkia Vau i Dejës e informon KMD, se struktura institucionale e Bashkisë Vau i Dejës ka në përbërje të saj një njësi organizative në nivel drejtorie, të quajtur *“Konvikti i Shkollës së Mesme Profesionale Kombëtare “Ndre Mjeda”*”, Bushat, me numër të përgjithshëm punonjësish 16 (gjashtëmbëdhjetë), sipas këtyre pozicioneve: 1 (një) drejtor konvikti, 4 (katër) kujdestarë, 1 (një) infermier, 1 (një) magazinier, 3 (tre) punëtorë mirëmbajtjeje, 2 (dy) sanitare, 1 (një) rrobalarëse, 3 (tre) roje. Në shkresën e Bashkisë Vau i Dejës theksohet fakti se në strukturën organizative të konviktit nuk është parashikuar ndonjë pozicion pune me emërtesën “edukator konvikti”, por “kujdestar konvikti”, përkatësisht 4 (katër) pozicione të tilla, për të cilët nuk është vendosur ndonjë kriter i veçantë arsimor, por thjesht kriteri është “arsimi i lartë”, pavarësisht profilit.

➤ Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 753/3, datë 07.07.2021, të KMD-së, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 21.07.2021, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së. Në vijim të njoftimit, Bashkisë Vau i Dejës iu dërgua e-mail, ku kërkohej që në seancë të depozitohej informacioni i mëposhtëm:

1. Kopje e strukturës organike aktuale të Konviktit të Shkollës së Mesme Kombëtare *“Ndre Mjeda”*, Bushat;
2. Kopje e strukturës organike paraardhëse të Konviktit të Shkollës së Mesme Kombëtare *“Ndre Mjeda”*, Bushat;
3. Numri i edukatorëve të konviktit të liruar nga detyra me të njëjtin motivacion me ankuesin, pas miratimit të strukture së re organike të Konviktit. Kopje të akteve të largimit nga puna.
4. Informacion nëse punonjësit që kanë punuar në pozicionin e “edukatorit të konviktit” aktualisht punojnë ende në pozicionin e “kujdestarit të konviktit”, pas miratimit të strukturës së re.
5. Informacion sa punonjës janë larguar në total nga Konvikti, si pasojë e miratimit të strukturës së re organike.
6. Kopje e lajmërim-marrjeve, që vërtetojnë që ankuesi ka marrë dijeni mbi shkresat e dërguara nga punëdhënësi për largim nga puna.

- Në seancë dëgjimore u paraqit ankuesi S.L. dhe përfaqësuesi me autorizim i Bashkisë së Vaut të Dejës⁶. Ankuesi parashitroi pretendimet e tij për diskriminim për shkak të bindjes politike, ku

⁶ Përfaqësuesi i Bashkisë Vau i Dejës sqaroi se informacioni i kërkuar me e-mail do të dërgohej në vijim të seancës dëgjimore.

ndër të tjera theksoi faktin se në datën 24.12.2020, edhe babai i tij, i cili kishte punuar pranë Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Vau i Dejës, ishte larguar nga puna, fakt të cilin e lidh me bindjet politike, pasi edhe kjo shoqëri është në varësi të Bashkisë Vau i Dejës.

Ai u shpreh se në datën 16.12.2020, i është kërkuar zyrtarisht nëpërmjet shkresës së Bashkisë Vau i Dejës, të paraqitej në takim për të diskutuar mbi marrëdhëniet e punës. S.L. shprehet se nuk është paraqitur në takim, pasi është kërcënuar politikisht për largim nga puna. Ai sqaron se paraprakisht Nën/Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës i ka kërkuar mbështetje politike për subjektin politik Partia Socialiste, mbështetje të cilën ankuesi shprehet se nuk ka pranuar t'ia japë, pasi ai është anëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë. Ankuesi thekson gjithashtu faktin se pavarësisht se ai nuk është paraqitur në takim, për të diskutuar mbi marrëdhëniet e punës, përfaqësuesit e Bashkisë Vau i Dejës nuk kanë mbajtur asnjë procesverbal, ku të evidentohet mos prania e tij në takim. Në datën 01.03.2020¹, Bashkia Vau i Dejës ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me të. Ai shprehet se ndaj tij nuk është dhënë asnjë masë disiplinore gjatë periudhës kohore që ka punuar pranë *Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale Kombëtare "Ndre Mjeda"*, Bushat, si dhe nuk ka patur vlerësime pune për punonjësit që kanë punuar pranë këtij konvikti. S.L. u shpreh se është zëvendësuar nga një punonjëse femër, e cila ka bindje të majta. Ai theksoi edhe një herë faktin se largimi nga puna, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ardhjen në detyrë të Kryetarit aktual të Bashkisë Vau i Dejës, i cili është përfaqësues i Partisë Socialiste të Shqipërisë, si dhe me konfliktet që S.L. ka patur me Nënkryetarin e Bashkisë. Ai u shpreh se punëdhënësi ka patur dijeni mbi bindjet e tij të djathta.

Ankuesi sqaroi se janë larguar nga puna edhe punonjës të tjerë të konviktit, të cilët kishin bindje të djathta dhe janë anëtarë të Partisë Demokratike, të tillë si V.N., A.P. dhe K.Sh. Personat që i kanë zëvendësuar janë anëtarë të Partisë Socialiste, të tillë si B.Sh etj. Përfaqësuesit e KMD e bënë me dije ankuesin se lidhur me këtë çështje, duhet të depozitonte informacion vijues pranë KMD-së.

Përfaqësuesi i Bashkisë Vau i Dejës, z. B. M. sqaroi se pretendimet e ankuesit ishin të pabazuara, pasi edhe ai vetë ishte anëtar i Partisë Demokratike dhe nuk kishte votuar për Kryetarin aktual të Bashkisë, por punonte ende pranë Bashkisë Vau i Dejës. Ai u shpreh se ankuesi ka patur performancë të mirë në punë. Përfaqësuesi i Bashkisë Vau i Dejës sqaroi se pothuajse çdo vit ky institucion bën ristrukturim të organikës së saj, të cilën e miraton Kryetari i Bashkisë. Kjo strukturë është miratuar në datën 25.12.2020, me Vendim të Këshillit Bashkiak. Në këtë kontekst, përfaqësuesit e KMD-së i kërkuan përfaqësuesit të Bashkisë, të dërgohej në vijim informacion lidhur me ndryshimin e strukturës së këtij institucioni. I pyetur, nëse struktura ku punon ankuesi ka patur ndryshime strukturore, përfaqësuesi i Bashkisë Vau i Dejës u përgjigj se kjo strukturë nuk ka patur ndryshime, por ankuesi ishte menduar të transferohej në një pozicion që të përshtatej me arsimin e tij. Ai sqaroi se ankuesi është ftuar në takim, për t'i komunikuar transferimin, procedurë kjo e ndjekur edhe me disa punonjës të tjerë. Por, S.L. nuk është paraqitur fare në këtë takim edhe pse ka marrë dijeni. Përfaqësuesit e KMD-së i vunë në dukje përfaqësuesit të Bashkisë Vau i Dejës se në shkresën drejtuar ankuesit citohej se takimi po kryhej për zgjidhjen e kontratës së punës, e jo

për një transferim të mundshëm. Përfaqësuesi i Bashkisë Vau i Dejes u shpreh se e njëjta procedurë ishte zbatuar edhe për punonjës të tjerë, të cilët kanë marrë të njëjtin njoftim, por janë transferuar dhe nuk janë larguar nga detyra. Ndër të tjera, përfaqësuesi i Bashkisë Vau i Dejes u shpreh se punëdhënësi nuk mund të mbajë në punë një punëmarrës, të cilin e njofton për takim dhe ai nuk paraqitet. Përfaqësuesit e KMD-së i kërkuan përfaqësuesit të Bashkisë Vau i Dejes, që në vijim të seancës dëgjimore të depozitonte pranë KMD-së, raste të këtyre transferimeve. I pyetur për strukturën e Bashkisë Vau i Dejes, nëse kjo strukturë ka patur zvogëlim të numrit të punonjësve, ai u shpreh se ka patur rritje të numrit të tyre dhe shtim sektorësh të ndryshëm, siç është ai i integritetit. Përfaqësuesi i Bashkisë Vau i Dejes u shpreh se ankuesi është larguar nga puna, sepse nuk është paraqitur në takimin e njoftuar zyrtarisht nga Kryetari i Bashkisë, duke e injoruar shkresën e këtij të fundit. Ai shpreh se nëse largimi i tij do të mbështetej në motive politike, atij do t'i jepej së pari masë disiplinore.

Përfaqësuesit e KMD-së e pyetën ankuesin, nëse ndaj tij ishte iniciuar ndonjë proces për dhënie mase disiplinore. Ai u shpreh se dikur është iniciuar një i tillë, por nuk ishte vijuar më tej. Ankuesi sqaroi gjithashtu se nuk kishte dijeni për çështjen e transferimit të tij në një pozicion tjetër pune, si dhe theksoi faktin se ishte aktivist me Partinë Demokratike, përkatësisht Sekretar i Seksionit Bushat. Largimi nga puna i dy anëtarëve të familjes së tij dëshmonte dhe nënkuptonte involvimin e motivit politik.

Përfaqësuesit e KMD-së e pyetën përfaqësuesin e Bashkisë Vau i Dejes, se përse kishte lindur nevoja për ta transferuar S.L. nga detyra që mbante, për sa kohë që sektori, ku ai punonte nuk kishte pësuar ndryshime strukturore, si dhe arsimi i kujdestarëve të konviktit ishte përcaktuar thjesht që duhej të ishte i lartë, kusht, të cilin ankuesi e plotësonte. Përfaqësuesi i Bashkisë Vau i Dejes u shpreh se një gjë e tillë ishte kryer për interesa të institucionit.

Përfaqësuesit e KMD-së i vunë në dukje përfaqësuesit të Bashkisë Vau i Dejes se institucioni, të cilin ai përfaqësonte kishte barrën e provës në këtë proces administrativ, si dhe e bënë me dije lidhur me faktin se në bazë të attributeve që Komisionerit, i jepen nga LMD, i ndryshuar, çështja të mund të zgjidhej nëpërmjet ndërmjetësimit, nëse palët do të binin dakord ndërmjet tyre.

- Në vijim të seancës dëgjimore, Bashkia Vau i Dejes dërgoi shkresën nr. 753/4 prot., datë 04.08.2021, nëpërmjet së cilës informon se ankimi i S.L. është i pabazuar. Bashkia Vau i Dejes sqaron se zgjidhja e marrëdhënieve të punës me ankuesin nuk është trajtuar në mënyrë të diferencuar nga punonjës të tjerë në kushte të njëjta me të.

Për të gjitha rastet është ndjekur e njëjta procedurë administrative si për rastin e S.L.. Në shkresë theksohet se pavarësisht faktit se procedurat e ndjekuara nga ana e Bashkisë Vau i Dejes, për zgjidhjen e kontratës së punës, kanë patur parregullsi, ato janë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe se është gjykata që vendos dhe shprehet në lidhje me këtë çështje. Në shkresën nr. 753/4 prot., datë

04.08.2021, theksohet fakti se pretendimet e ankuesit se ai aderom në Partinë Demokratike, si anëtar i Forumit Rinor të kësaj partie dhe se për këtë shkak është larguar nga puna nuk qëndron. Pretendimi i ankuesit kundërshtohet me argumentin se në Bashkinë Vau i Dejës ka qenë i punësuar z. M. T., në pozicion përgjegjës sektori në Bashki, ndërkohë që drejtonte Forumin Rinor të PD-së dhe se nuk është larguar nga puna për këtë shkak, megjithëse të qënit njëkohësisht edhe drejtues i strukturës politike dhe drejtues i njësisë organizative binte ndesh me legjislacionin për nëpunësin civil. Njëkohësisht, Bashkia Vau i Dejës sqaron se pretendimi i ankuesit se edhe Drejtori i Konviktit z. K.Sh. është larguar nga puna për shkak të bindjes politike, nuk qëndron pasi ky i fundit, është larguar si pasojë e çështjes së dekriminalizimit.

Në korrespondencën zyrtare të këtij institucioni është theksuar fakti sikurse citohet: *“Më poshtë sjellin raste krahasuese në nivele drejtuese të administratës, të cilët ushtrojnë detyrën shtetërore, pa u ndikuar nga cilido shkak i përmendur nga ankuesi. Znj. J.M. drejton Drejtorinë Ekonomike, z. B. M. drejton Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, znj. A. Sh. drejton Drejtorinë e Planifikimit Urban, znj. M.Gj. drejton Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, z. Z.U. drejton Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave, z. J.P. drejton Sektorin e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, z. A.V. drejton Sektorin e GIS dhe Kadastrës, znj. K. Sh. drejton Sektorin e Asistencës Ligjore, znj. N. B. drejton Sektorin e Fuqizimit Ekonomik, znj. V.N. drejton Sektorin e Emergjencave Civile, znj. A. N. drejton Sektorin e Auditit të Brendshëm, z. M. L. drejton Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit, znj. A. Gj. drejton Sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit, znj. C.B. drejton Sektorin e Shërbimit Social dhe Strehimit.*

Të gjithë personat e lartpërmendur mbajnë pozicionet e punës që kanë pasur para zgjedhjeve vendore të 30 qershorit 2019 dhe shumica prej tyre janë anëtarë të P.D., çfarë do të thotë se në Bashkinë Vau i Dejës punonjësit nuk trajtohen në mënyrë të diferencuar, për shkak të bindjeve të tyre politike”.

Në shkresën e Bashkisë Vau i Dejës theksohet fakti se nëse pretendimi i ankuesit se Bashkia Vau i Dejës ka larguar nga puna punonjës për shkak të bindjes politike do të ishte i mbështetur, atëherë veprimi politik do të godiste nivelet drejtuese në administratën publike, por jo të godiste S.L., i cili nuk ka peshë politike.

Në shkresën e Bashkisë Vau i Dejës theksohet fakti se pretendimet e ankuesit, se zgjidhja e kontratës së punës i është bërë për shkak të bindjeve politike janë sa absurde dhe jo ligjore, sepse ai vetë me sjelljen e tij ka demonstruar një gjë të tillë, duke injoruar Kryetarin e Bashkisë Vau i Dejës (punëdhënësin) për shkak të bindjeve politike, duke mos i shkuar në takim sepse sipas tij, ai vinte si i zgjedhur nga Partia Socialiste. Këtë sjellje ankuesi e ka demonstruar edhe në seancë dëgjimore para KMD-së, ku ka përsëritur disa herë thënien që *“unë nuk shitem”*.

Bazuar në strukturën e re të institucionit për vitin 2021, Bashkia Vau i Dejës, me shkresën nr. 7298, datë 11.12.2020, ka njoftuar z. S.L. se Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës do të fillojë procedurën e

zgjidhjes së kontratës individuale të punës, me qëllim sistemimin e tij në një pozicion tjetër pune brenda institucionit, pas ristrukturimit.

Me shkresën nr. 295, datë 14.12.2020, Bashkia Vau i Dejës ka njoftuar të gjithë punonjësit e strukturave organizative në bashki për fillimin e procedurave të ristrukturimit, i cili është mbyllur më 29.12.2020. Referuar Raportit të Komisionit të Ristrukturimit rezulton se në administratën e Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2021 të jenë 16 vende të lira pune në nivel ekzekutiv dhe 18 vende të lira pune në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues.

Z. S.L., megjithëse ka marrë dijeni për njoftimin e punëdhënësit për takim, ai nuk i është bindur thirrjes së punëdhënësit për takim, duke e injoruar plotësisht atë vetë për shkak të bindjeve të tij, politike, veprim ky që bie ndesh me nenin 23, të ligjit nr. 7661, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, si dhe në nenin 8 të kontratës individuale të punës. Qëllimi i këtij takimi ishte, që palët të kishin mundësi të parashtronin dhe të diskutonin me njëra tjetrën mbi mundësinë dhe shkakun ligjor për fillimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës individuale të punës. Duke qenë se punëmarrësi nuk iu përgjigj thirrjes për takim me punëdhënësin, Bashkia Vau i Dejës ka hartuar njoftimin për zgjidhjen e kontratës individuale të punës, nëpërmjet shkresës së saj nr. 7298/1, datë 21.12.2020, duke vendosur një afat 2 (dy) mujor, i cili fillonte nga momenti i marrjes dijeni mbi njoftimin për shkak se marrëdhëniet e punës nuk do të mund të vazhdonin për shkak të thyerjes së marrëdhënieve të besimit në punë.

Pas përfundimit të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, Bashkia Vau i Dejës ka nxjerrë Urdhërin nr. 78, datë 26.02.2021, nëpërmjet së cilës ka ndërprerë marrëdhëniet administrative dhe financiare me punëmarrësin në datën 01.03.2021. Theksohet fakti se punëmarrësi nuk ka bërë ankim kundër vendimit për zgjidhjen e kontratës individuale të punës në Bashkinë Vau i Dejës, por i është drejtuar me padi direkte në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

- KMD iu drejtua Bashkisë Vau i Dejës me shkresën nr. 753/5, datë 05.08.2021, nëpërmjet së cilës kërkoi informacionin e mëposhtëm:
- 1. Kopje të strukturës organike aktuale të Bashkisë Vau i Dejës dhe asaj të Konviktit të Shkollës së Mesme Kombëtare “*Ndre Mjeda*”, Bushat, si dhe kopje të praktikës së të gjithë akteve pararendëse, që çuan në miratimin e strukturës së kësaj bashkie;
- 2. Kopje të strukturës organike paraardhëse të Bashkisë Vau i Dejës dhe asaj të Konviktit të Shkollës së Mesme Kombëtare “*Ndre Mjeda*”, Bushat;
- 3. A ka patur rritje të numrit organik të punonjësve të Bashkisë Vau i Dejës? Nëse po, të jepet informacion mbi sektorët, ku ka patur rritje të numrit të punonjësve;
- 4. A ka patur ndryshim të numrit të përgjithshëm të punonjësve të Konviktit të Shkollës së Mesme Kombëtare “*Ndre Mjeda*”, Bushat, si pasojë e ndryshimeve strukturore? A ka patur ndryshim në numrin organik të pozicioneve të kujdestarëve të konviktit?

5. Informacion mbi numrin e edukatorëve/kujdestarëve të konviktit të liruar nga detyra, me të njëjtin motivacion me ankuesin, pas miratimit të strukturës së re organike të këtij Konvikti. Kopje të akteve të lirit nga detyra;
 6. Informacion mbi numrin e punonjësve, që kanë punuar në pozicionin e edukatorit/kujdestarit të konviktit, sipas strukturës paraardhëse të Konviktit të Shkollës së Mesme Kombëtare “*Ndre Mjeda*”, Bushat dhe që aktualisht punojnë ende në të njëjtin pozicion pune edhe pas miratimit të strukturës së re organike të këtij institucioni;
 7. Informacion mbi numrin total të punonjësve, që janë larguar nga Konvikti, si pasojë e miratimit të strukturës së re organike;
 8. Kopje e lajmërim-marrjeve, që vërtetojnë se ankuesi ka marrë dënimin mbi shkresat e dërguara nga punëdhënësi, lidhur me procedurën e lirit nga detyra;
 9. Informacion nëse ndaj ankuesit është ndërmarrë një procedurë tjetër paraardhëse për largim nga puna, në muajin shtator 2019? Nëse po të dërgohen aktet përkatëse.
- Bashkia Vau i Dejës dërgoi shkresën nr. 1214, datë 23.08.2021⁷, nëpërmjet së cilës sqaron se referuar çështjeve për të cilat kërkohej informacion, Bashkia Vau i Dejës ka dërguar informacion, nëpërmjet shkresës parardhëse.

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Ankuesi S.L. është emëruar në pozicionin e Edukatorit të Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “*Ndre Mjeda*”, Bushat, nëpërmjet Urdhërit nr. 01, datë 01.01.2015, të Kryetarit të Komunës Bushat. Marrëdhëniet e punës janë rregulluar nëpërmjet kontratës individuale të punës së lidhur në datën 04.01.2016, me Kryetarin e Bashkisë Vau i Dejës, e cila ka qenë me afat të caktuar deri në datën 04.01.2017, por që në përfundim të afatit është zgjidhur në heshtje me vullnet të dy palëve.

Nëpërmjet shkresës nr. 7298 prot., datë 11.12.2020, së Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, S.L. është njoftuar për fillimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës individuale të punës. Në këtë kontekst, ankuesi njoftohet se brenda 72 orësh, pas momentit të njoftimit, ai duhet të paraqitet në zyrën e Nënkyetarit të Bashkisë Vau i Dejës, pasi ai është i autorizuar të

⁷ Numri dhe data e regjistrimit pranë KMD-së.

parashtrojë para S.L., arsyen dhe shkakun ligjor të procedurës së filluar, si dhe do të diskutojë arsyet e mundësisë së zgjidhjes së kontratës individuale të punës.

Në parashtrimet e Bashkisë Vau i Dejës është theksuar fakti se qëllimi i takimit me ankuesin ka qenë diskutimi i marrëdhënieve të punës dhe transferimi i tij në një pozicion tjetër, ndërkohë që në aktin përkatës të njoftimit nuk rezulton të jetë shënuar një klauzolë e tillë.

Në vijim, në adresë të S.L., i cili nuk është paraqitur në këtë takim, është dërguar shkresa nr. 7298/1, datë 21.12.2020, nëpërmjet së cilës ai njoftohet për zgjidhjen e kontratës së punës, brenda një afati 2 (dy) mujor, afat ky që fillon nga momenti i marrjes dijeni të këtij njoftimi.

Pas përfundimit të afatit të sipërcituar, nëpërmjet Urdhërit nr. 78, datë 26.02.2021, të Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës është vendosur zgjidhja e marrëdhënies së punës me punëdhënësin. Në pikat 1 dhe 2, të këtij Urdhëri citohet: *“1.Zgjidhjen e kontratës individuale të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare me Edukatorin e Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Ndre Mjeda” Bushat. 2. Marrëdhëniet administrative dhe financiare punonjesit t’i ndërpriten në datë 01.03.2021”*.

Për sa më sipër, nga analiza e akteve të sipërcituara, Komisioneri konstatoi se në aktet e sipërpërmendura nuk evidentohet motivacioni i largimit nga puna, si dhe nuk rezulton akti i procesverbalit të takimit, ku të reflektohet mosprezenca e ankuesit, pavarësisht faktit se ankuesi e ka pranuar para Komisionerit se nuk ka marrë pjesë në takim.

Në kushtet kur, në shkresat zyrtare të Bashkisë Vau i Dejës është përmendur fakti i ristrukturimit të këtij institucioni dhe institucioneve në varësi të tij, duke e informuar se procedura e largimit nga puna të ankuesit lidhet me këtë proces ristrukturimi, KMD mori në shqyrtim këto akte, të cilat u dorëzuan në cilësi prove nga ana e Bashkisë Vau i Dejës.

Për sa më sipër, nëpërmjet Vendimit nr. 31, datë 14.12.2020 *“Për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit dhe Sistemimit të nëpunësve/punonjësve të Bashkisë Vau i Dejës dhe Njësieve Administrative, në varësi, në përputhje me strukturën e re organizative”* është ngritur Komisioni i Ristrukturimit dhe Transferimit të nëpunësve civilë, në përbërje të së cilit janë tre anëtarë.

Me anë të shkresës nr. 295 Prot., datë 14.12.2020 *“Njoftim mbi fillimin e procedurave të ristrukturimit”*, të Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore drejtuar nëpunësve të strukturave organizative dhe administrative të Bashkisë Vau i Dejës dhe për dijeni Kryetarit të Bashkisë, të gjithë këto struktura njoftohen për fillimin e procedurave të ristrukturimit dhe sistemimit të nëpunësve civilë në strukturat përkatëse të Bashkisë.

Në vijim, është miratuar Vendimi nr. 79, datë 24.12.2020, i Këshillit Bashkiak *“Për miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur e të emëruar, nëpunësit civilë dhe punonjësit administrative të Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2021”*. Në këtë akt, përkatësisht në Lidhjen 2 të tij, *“Niveli i pagave për konviktin e Shkollës së Mesme Profesionale “Ndre Mjeda”*, ndër të tjera përcaktohet niveli i pagave sipas strukturës për vitin 2021, së këtij Konvikti.

Në Aktin nr. 324 prot., datë 29.12.2020, *“Raport i Komisionit të Ristrukturimit mbi zhvillimin dhe realizimin e procedurës së restrukturimit dhe sistemit të nëpunësve civilë në administratën e Bashkisë Vau i Dejës dhe Njësive Administrative në varësi, bazuar në strukturën e re organizative”* është raportuar se ekzistojnë disa vende vakante në strukturën e Bashkisë Vau i Dejës. Për sa më sipër, në këtë Raport është evidentuar se për vitin 2021, ekzistojnë 16 vende të lira pune në nivel ekzekutiv dhe 18 vende të lira pune në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues pranë këtij institucioni, fakt që dëshmon për rritje të numrit të pozicioneve të punës. Një informacion i tillë u dha edhe në seancë dëgjimore edhe nga ana e ana e përfaqësuesit të këtij institucioni.

Për sa më sipër, në Vendimin nr. 79, datë 24.12.2020, e Këshillit Bashkiak, *“Për miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur e të emëruar, nëpunësit civilë dhe punonjësit administrative të Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2021”* si dhe Vendimin nr. 291, datë 19.11.2019, e Këshillit Bashkiak *“Për miratimin e strukturës organizative, organigramën, kategoritë dhe klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe administrative për vitin buxhetor 2020”*, përcaktohet niveli i pagave për secilin pozicion pune brenda Bashkisë Vau i Dejës dhe institucioneve në varësi. Referuar akteve të sipërcituara, të cilat kanë në përmbajtje edhe organikat respektive të Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale *“Ndre Mjeda”*, Bushat, rezulton se kjo strukturë organike është e pandryshuar. Në të dy strukturat e sipërcituara të Konviktit rezulton se numri i përgjithshëm i punonjësve të tij është 16 (gjashtëmbëdhjetë). Në strukturën organike të vitit 2020 bëjnë pjesë: 1 (një) drejtor konvikti, 4 (katër) kujdestarë konvikti, 1 (një) infermier, 1 (një) magazinier, 3 (tre) punëtorë mirëmbajtjeje, 2 (dy) sanitare, 1 (një) rrobalarëse dhe 3 (tre) roje. Njëkohësisht, edhe në strukturën e vitit 2021 rezulton se numri i punonjësve është sërish 16 (gjashtëmbëdhjetë) dhe numri i kujdestarëve është i njëjtë, 4 (katër) të tillë.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se në kushtet kur, Konvikti i Shkollës së Mesme Profesionale *“Ndre Mjeda”*, Bushat nuk ka patur suprimim të numrit të pozicioneve të punës në tërësi dhe të kujdestarëve të konviktit në veçanti, fillimi i procedurave për largimin nga puna të S.L. është totalisht i pamotivuar dhe i paarsyeshëm, aq më tepër kur edhe në aktin e largimit nga puna nuk rezulton të jetë përmendur asnjë motivacion për këtë largim. Referuar kopjes së librezës së punës së ankuesit, që është depozituar në cilësi prove rezulton se në të

është vënë shënimi “*zgjidhje e kontratës së punës*”, por në asnjë rast nuk është shënuar se largimi i tij ka qenë për shkak të ristrukturimit.

Vlen të theksohet fakti, se në bazën ligjore të aktit të largimit nga puna të S.L., në asnjë rast nuk është përmendur asnjë nga aktet e praktikës së ristrukturimit të Bashkisë Vau i Dejës, fakt që krijon dyshimin e arsyeshëm se largimi i tij nuk ka asnjë lidhje me ndryshimet strukturore të Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “*Ndre Mjeda*”, Bushat, e cila është e njëjtë me parardhësen.

Në pozicionin e dikurshëm të punës së S.L. është emëruar një punonjëse e re, e cila i plotëson kriteret e punësimit, sikurse ankuesi, pasi mbështetur në korrespondencën zyrtare të Bashkisë Vau i Dejës rezulton se kriteri i vetëm i punësimit për pozicionin “*kujdestar konvikti*” është arsimi i lartë. Bashkia Vau i Dejës ka depozituar kopje të diplomës bachelor dhe listës së notave të znj. B.Sh.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Bashkisë Vau i Dejës u shpreh se procedura e ndjekur ndaj punonjësve të tjerë të Konviktit ishte e njëjtë me atë të ndjekur me ankuesin, por ata janë paraqitur në takim me Kryetarin e Bashkisë dhe si rrjedhim janë sistemuar në pozicione të tjera pune. Sipas Bashkisë Vau i Dejës, mosparaqitja në takim dhe “*injorimi*” i shkresës Kryetarit të Bashkisë, ku kërkohej takim, ka qenë edhe arsyeja e penalizimit të S.L. dhe si rrjedhim largimi i tij nga puna.

Nëpërmjet shkresës nr. 753/5, datë 05.08.2021 së KMD-së është kërkuar informacion mbi numrin e kujdestarëve të konviktit të liruar nga detyra, sikurse ankuesi, pas miratimit të strukturës së re të këtij Konvikti, si dhe janë kërkuar kopje të akteve të lirimit nga detyra. Bashkia Vau i Dejës nuk e ka dërguar këtë informacion pranë KMD-së. Nëpërmjet së njëjtës shkresë, KMD ka kërkuar informacion edhe mbi numrin e punonjësve që kanë punuar në pozicionin e edukatorit/kujdestarit të konviktit, sipas strukturës paraardhëse të Konviktit të Shkollës së Mesme Kombëtare “*Ndre Mjeda*”, Bushat dhe që aktualisht punojnë ende në të njëjtin pozicion pune edhe pas miratimit të strukturës së re organike të këtij institucioni. Edhe për këtë çështje, Bashkia Vau i Dejës nuk ka dërguar informacion pranë KMD-së, fakt që rëndon pozitën e këtij institucioni, i cili ka barrën e provës në këtë proces administrativ.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se Bashkia Vau i Dejës nuk e ka justifikuar në asnjë rast largimin nga puna të S.L. dhe e ka ekspozuar ankuesin ndaj një qendrimi të padrejtë dhe të pafavorshëm.

B. Shkaku i mbrojtur “bindja politike”.

Z. S.L. pretendon diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, nga ana e Bashkisë Vau i Dejës.

“*Bindja politike*” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, Komisioneri gjykon se “*bindja politike*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur. Ankuesi ka depozituar gjithashtu në cilësi prove kopje të Kartës së Anëtarësimit me nr. personal I5060210SS, datë 10.11.2012⁸, lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, ku rezulton se S.L. është anëtar i Partisë Demokratike, kopje të dy kartave të anëtarësisë në Kuvendin Kombëtar të këtij subjekti politik, të lëshuara përkatësisht në datat 28-29 prill 2018 dhe 15 dhjetor 2018, si dhe kopje të shkresës nr. 32, datë 18.05.2021, së Partisë Demokratike të Shqipërisë, Dega Vau i Dejës, ku vërtetohet se z. S.L. është anëtar i Partisë Demokratike, Dega Vau i Dejës, si dhe mban pozicionin e sekretarit të grup/seksionit Bushat Dega Vau i Dejës.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur – bindja politike.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se z. S.L. i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Vau i Dejës.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore, që i garantohet individit lidhur me shkakun e bindjes politike, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar.

Për sa më sipër, parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit parashikohet nga Kushtetura e Republikës së Shqipërisë, si dhe nga akte të tjera ligjore, duke sanksionuar njëkohësisht edhe zbatimin e tij nga të gjithë shtetasit shqiptarë. Referuar nenit 49, të Kushtetutës së Republikës parashikohet: “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me*

⁸ Vlefshmëria e kartës së anëtarësisë është deri në datën 12.10.2022;

punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”. Në këtë sens, kjo dispozitë i garanton çdo individ të drejtën për punë. Neni 18, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht: “Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.”

Njëkohësisht, në referencë të nenit 14, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut garantohet barazia e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, sikurse edhe në Kartën Social Europiane (të rishikuar) dhe Shtojcën e saj përkatësisht në nenin 24, pika 3, gërma d) parashikohet shprehimisht: “....Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit....d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare përgjegjësitë familjare, shtatëzania, besimi fetar, opinion politik, prejardhja kombëtare ose origjina sociale”.

Referuar Vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtësisë⁹, për çështjen *Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2012), duke u mbështetur në parimin e nenit 11, të KEDNJ-së, që partitë politike janë thelbësore për funksionimin e duhur të demokracisë, Gjykata konsideron: “Duke pasur parasysh rëndësinë e demokracisë në sistemin e Konventave, Gjykata konsideron se në mungesë të masave mbrojtëse gjyqësore një sistem juridik, i cili lejon largimin nga puna vetëm për shkak të anëtarësimit të punonjësve në një parti politike mbart me vete mundësinë e abuzimit” (paragrafi 55).

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Në nenin 12, pika 1, gërma (c), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “1.Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin

⁹ Redfearn v. The United Kingdom: ECHR 6 Nov 2012;

nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”

Diskriminimi përkuftizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Neni 9, pikat 9 & 10, të Kodit të Punës parashikojnë shprehimisht: “9. Në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë.”

Kodi i Procedurës Administrative¹⁰ ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Vau i Dejës, e cila duhet të provojë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

LMD, i ndryshuar, ka saktësuar gjithashtu se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Vau i Dejës, që duhet të provojë se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues për shkak të bindjes së tij, politike.

Kështu, neni 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar, përcakton se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave

¹⁰ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS¹¹ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë **se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues**.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore, midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë ose,
2. Duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti kundër së cilit drejtohet ankesa nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹²

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet, kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*¹³”.

¹¹ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

¹² https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹³ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev*

Në lidhje me rastin në fjalë, mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të depozituara nga ankuesi, si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit nga ana e Bashkisë Vau i Dejës, pasi atij i është zgjidhur kontrata e punës dhe është larguar nga pozicioni i punës “*kujdestar konvikti*” pa asnjë motivacion dhe në kushtet kur, struktura e Konviktit të Shkollës së Mesme Kombëtare “*Ndre Mjeda*”, Bushat, nuk ka ndryshuar dhe numri i pozicioneve të kujdestarëve nuk është suprimuar, por është i njëjtë me strukturën paraardhëse. Njëkohësisht, në vend të tij është emëruar një punonjëse e re.

Përsa i përket bindjeve politike të ankuesit, mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe specifikisht referuar Kartës së Anëtarësimit me nr. personal I5060210SS, datë 10.11.2012, lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, rezulton se ankuesi S.L. është anëtar i subjektit politik Partia Demokratike. Njëkohësisht, në referencë të dy Kartave të Anëtarësimit të lëshuara nga Partia Demokratike, në datat 28-29 prill 2018 dhe 15 dhjetor 2018, rezulton se ankuesi ka qenë anëtar i Kuvendit Kombëtar të kësaj force politike. Referuar Vërtetimit nr. 32 prot, datë 18.05.2021, rezulton gjithashtu se ankuesi, i cili është banor i fshatit Pleshë, Njësia Administrative Bushat, mban edhe pozicionin e sekretarit të grup/seksionit Bushat Dega, Vau i Dejës.

Për sa më sipër, Komisioneri çmon se Bashkia Vau i Dejës ka patur dijeni mbi përkatësinë politike të ankuesit, pasi në asnjë shkresë të dërguar nga ana e saj në adresë të KMD-së, nuk është mohuar një fakt i tillë, ndërkohë që është fakt i njohur që Kryetari i kësaj Bashkie është përfaqësues i subjektit politik Partia Socialiste. Njëkohësisht, Komisioneri gjykon se në bashki të tilla si ajo e Vaut të Dejës, ku numri i popullsisë nuk është i madh, banorët e njohin mirë njëri tjetrin dhe kanë dijeni mbi përkatësinë politike të njëri tjetrit¹⁴.

Njëkohësisht, Bashkia Vau i Dejës në asnjë rast nuk e ka justifikuar me fakte dhe prova të mbështetura, largimin nga puna të ankuesit, në kushtet kur, në Urdhërin nr. 78, datë 26.02.2021, të Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës është vendosur zgjidhja e marrëdhënies së punës me punëdhënësin dhe në të nuk ka asnjë motivacion për largimin e tij. Largimi i tij nga puna është justifikuar për efekt të ristrukturimit të institucionit, ndërkohë që rezulton se në bazë të Vendimit nr. 79, datë 24.12.2020, të Këshillit Bashkiak, “*Për miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur e të emëruar, nëpunësit civilë dhe punonjësit*

kundër Rusisë (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

¹⁴ Bashkia Vau i Dejës përbëhet nga 6 njësi administrative me një popullsi prej 50 130 banorë, përkatësisht: Vau-Dejës me 13 035 banorë, Bushat me 24 200 banorë, Vig-Mnelë me 2 177 banorë, Hajmel me 6 300 banorë, Temal me 2 520 banorë dhe Shllak me 1 899 banorë.

administrative të Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2021” nuk ka patur ndryshime strukturore në Konviktin e Shkollës së Mesme Kombëtare “*Ndre Mjeda*”, Bushat dhe numri i punonjësve është i njëjtë.

Njëkohësisht, në Aktin nr. 324 prot., datë 29.12.2020, “*Raport i Komisionit të Ristrukturimit mbi zhvillimin dhe realizimin e procedurës së ristrukturimit dhe sistemit të nëpunësve civilë në administratën e Bashkisë Vau i Dejës dhe Njësive Administrative në varësi, bazuar në strukturën e re organizative*” është raportuar se ekzistojnë disa vende vakante në strukturën e Bashkisë Vau i Dejës. Për sa më sipër, në këtë Raport është evidentuar se për vitin 2021, ekzistojnë 16 vende të lira pune në nivel ekzekutiv dhe 18 vende të lira pune në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues pranë këtij institucioni, fakt që dëshmon për rritje të numrit të pozicioneve të punës. Por, pavarësisht tyre, ankuesi është larguar nga puna dhe nuk është sistemuar në punë.

Në korrespondencën zyrtare të këtij institucioni është cilësuar se ka punonjës të tjerë që kanë qendruar në punë, bindjet politike të së cilëve janë të djathta sikur të ankuesit, por në asnjë rast nuk është provuar një fakt i tillë me aktet dhe provat përkatëse. KMD gjykon se nuk disponon informacion të mjaftueshëm mbi faktin, nëse punonjësit në fjalë kanë bindje të djathta dhe nëse ndodhen në pozita të njëjta apo të ngjashme me ankuesin. Njëkohësisht, KMD gjykon se nuk ka informacion nëse në mbajtjen e tyre në punë, nuk ka patur ndikim të rrethanave të tjera, të cilat nuk kanë qenë të njëjta për S.L., i cili është larguar nga puna. Komisioneri gjykon se prezenca në punë e punonjësve të tjerë që mund të kenë bindje dhe anëtarësi opozitare me titullarët e subjektit politik në pushtet nuk përbën fakt bindës se largimi nga puna i S.L. nuk është bërë për shkak të bindjeve politike.

Në kushtet kur, ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t’u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e garantuar nga Kodi i Punës, është një e drejtë e mbrojtur shprehimisht me ligjin nr.10221 datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, është e natyrshme që kjo e drejtë vendos detyrime mbi çdo punëdhënës që krijon, ndryshon apo i jep fund marrëdhënies së punës, të ndërmarrë veprime në përputhje me të drejtën e punëmarrësve për mbrojtjen nga diskriminimi. Në rastin konkret, bindjet politike përbëjnë shkak diskriminues për përfundimin e marrëdhënies së punës, sa kohë që punëdhënësi ka dështuar të japë shpjegime alternative e të besueshme se largimi nga puna i ankuesit është bërë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se z. S.L. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të bindjes politike, nga ana e Bashkisë Vau i Dejës.

Përveç sa më sipër, ankuesi S.L. ka kërkuar nga Komisioneri edhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, largimi prej së cilit është kryer në kushtet e diskriminimit për bindjet politike.

Në nenin 33, pika 10, të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”*, ndërsa mbështetur në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: *“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”*.

Në nenin 33, pika 10, të LMD, të ndryshuar nuk janë përcaktuar masat që duhen ndërmarrë për rregullimin e situatës diskriminuese, atribut ky që është lënë në diskrecionin e Komisionerit. Në këtë kontekst, Komisioneri vendos rast pas rasti, se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të individëve që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit.

Përveç sa më sipër, në nenin 9/9, të Kodit të Punës, parashikohet shprehimisht se në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. Ligji i posaçëm që rregullon mbrojtjen nga diskriminimi, është Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar. Në nenin 38 të LMD, të ndryshuar, i cili jep përkufizimin e dëmshpërblimit, që jepet nga gjykata kompetente në rastet e konstatimit të diskriminimit, parashikohet shprehimisht se: *“Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e dëhur për dëmet pasurore si dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme.”*

Nëpërmjet këtij parashikimi ligjor, në rastet kur konstatohet se ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur si pasojë e diskriminimit, një nga mënyrat e dëmshpërblimit është rikthimi i punonjësit në gjendjen e mëparshme. Komisioneri çmon se, rikthimi në gjendjen e mëparshme realizohet duke e rivendosur marrëdhënien e punësimit të ndërprerë për shkak të diskriminimit. Komisioneri ka konstatuar se sjellja diskriminuese ndaj ankuesit konsiston pikërisht në përfundimin e marrëdhënies së punës dhe largimin e saj nga puna. Si rrjedhim, edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit.

Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese, të shkaktuar si pasojë e largimit nga puna të ankuesit, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke e sistemuar ankuesin në një pozicion pune të barazvlefshëm me pozicionin e mbajtur më

parë prej tij. Komisioneri çmon se sistemimi i ankuesit në punë, është një masë rregulluese, e cila është në përpjestim me gjendjen që ka shkaktuar vendosjen e kësaj mase.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se mbrojtja nga diskriminimi e garantuar nga LMD, i ndryshuar, nuk do të ishte efektive nëse punëdhënësi nuk detyrohet të rivendosë marrëdhënien e punësimit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pikat 1 dhe 3, nenit 12, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-12, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të z. S.L., për shkak të bindjes politike, nga Bashkia Vau i Dejës.
2. Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për sistemimin e ankuesit në një pozicion pune të barazvlefshëm me pozicionin e mbajtur më parë prej tij.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Bashkia Vau i Dejës, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i ndryshuar, moszbatimi i këtij Vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha – Punësim
Shkak – bindja politike
Lloji i vendimit - diskriminim